

ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA

Rezultatet nga
gjurmimi i të
diplomuarve
2017-2022



Shkolla e mesme profesionale “Gjergj Canco”

Rezultatet nga gjurmimi i të diplomuarve 2017-2022

Tetor 2023

Ky raport është hartuar nga Fjorela Pahumi nën kujdesin e Aleka Papa, Projekti “Aftësi për Punë” (S4J).
Koordinatorë për gjurmimin në shkollën “Gjergj Canco”: Loreta Polaj

Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?	5
2. Të diplomuarit 2017-2021	6
3. Rezultatet	7
3.1 Statusi i punësimit.....	7
3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit	9
3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës	10
3.4 Niveli i pagave.....	11
3.5 Kushtet e punës	12
3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës.....	13
3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë.....	14
3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë	15
3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme	16
3.10 Të diplomuarit pa punë.....	17
3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë	19
3.12 Planet për të ardhmen	21
4. Përfundime	22

Tabela e figurave

Figura 1 Shpërndarja e gjurmimit sipas gjinisë	6
Figura 2 Shpërndarja e gjurmimit sipas drejtimit	6
Figura 3 Vendi i banimit (të diplomuarit 2020, 2021).....	7
Figura 4 Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2021).....	8
Figura 5 Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit	8
Figura 6 Punësimi përkundrejt vetë-punësimit	8
Figura 7 Statusi i punësimit sipas drejtimit (të diplomuarit 2021)	9
Figura 8 Statusi i punësimit sipas gjinisë (të diplomuarit 2021)	9
Figura 9 Lidhja e punës me fushën e arsimit	9
Figura 10 Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimeve (2020,2021)	9
Figura 11 Niveli i pagave një vit pas diplomimit (neto)	11
Figura 12 Niveli i pagave sipas gjinisë (2021).....	12
Figura 13 Niveli i pagave sipas drejtimit (2021).....	12
Figura 14 Punësimi me kohë të plotë përkundrejtë me kohë të pjesshme.....	12
Figura 15 Madhësia e kompanisë	13
Figura 16 Lloji i kontratës.....	13
Figura 17 Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi.....	13
Figura 18 Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2021).....	15
Figura 19 Llojet e kualifikimeve të mëtejshme	16
Figura 20 Llojet e kualifikimeve të mëtejshme	17
Figura 22 Lloji i universitetit.....	17
Figura 21 Lidhja e fushës së studimeve/trajnimeve me profesionin	17
Figura 23 Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë	18
Figura 24 Metoda e kërkimit për punë (të diplomuar në 2020, 2021)	19
Figura 25 Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune	19
Figura 26 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë	20
Figura 27 Përzgjedhja e së njëjtës degë sipas gjinisë.....	Error! Bookmark not defined.
Figura 28 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë sipas gjinisë	Error! Bookmark not defined.

Tabele e tabelave


Tabela 1 Mbulimi i gjurmimit.....	6
Tabela 2 Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit	10
Tabela 3 Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve	10
Tabela 4 Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual me studimet.....	11
Tabela 5 Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale.....	14
Tabela 6 Periudha kohore në kërkim të një pune.....	14
Tabela 7 Mënyrat e gjetjes së punës së parë.....	15
Tabela 8 Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë	16
Tabela 9 Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme.....	17
Tabela 10 Papunësia ndër vite	18
Tabela 11 Arsyeja kryesore pas papunësisë	18
Tabela 12 Arsyet kryesore e mos kërkimit për punë	19
Tabela 13 Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë “shumë/jashtëzakonisht shumë”	20
Tabela 14 Përzgjedhja e së njëjtës degë/shkollë sipas drejtimit	20
Tabela 15 Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme.....	21

1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes ‘studimeve gjurmuese’ që ndjekin ose ‘gjurmojnë’ të diplomuarit pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.


Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, **shkolla e mesme profesionale ‘Gjergj Canco’**, me mbështetjen e projektit ‘Aftësi për Punë’ (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

- Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
- Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësi të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësi të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njesisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit ‘Aftësi për punë’.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **gjashtë brezave me të diplomuar** të shkollës së mesme profesionale ‘Gjergji Canco’.

2. Të diplomuarit 2017-2022

Tabela 1 përmbledh shkallën e pjesëmarrjes në gjurmim. 89% e të diplomuarve të 2022 u gjurmuan një vit pas diplomimit.

Tabela 1 Mbulimi i gjurmimit

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2016-2017	201	121	60%
2017-2018	201	121	60%
2018-2019	241	176	73%
2019-2020	208	165	79%
2020-2021	187	158	85%
2021-2022	145	129	89%

Figura 1 dhe 2 paraqesin shkallën e shpërndarjes në gjurmim sipas drejtimit dhe gjinisë. Në 2023 58% e të gjurmuarve kanë ndjekur drejtimin Elektroteknikë dhe 42% TIK dhe 97% e tyre janë meshkuj.

Figura 2 Shpërndarja e gjurmimit sipas drejtimit






Figura 1 Shpërndarja e gjurmimit sipas gjinisë



88% e të diplomuarve të anketuar banonin në Shqipëri ndërsa 12% jashtë Shqipërisë. Shifrat tregojnë një tendencë në rritje të të gjurmuarve që banojnë jashtë Shqipërisë. Të diplomuarit jashtë Shqipërisë ndodhen në këto shtete: Angli (5), Gjermani (4), Itali (1), SHBA (1), Maltë (1), Spanjë (1), Zvicër (1).

Figura 3 Vendi i banimit (të diplomuarit 2020, 2021, 2022)



Disa nga gjetjet nga paragjurmimi i të diplomuarve:

- 93% (141 nga 152) e maturantëve u bënë pjesë e paragjurmimit;
- 35% e të gjurmuarve ishin në marrëdhënie pune - 41% në drejtimin Elektroteknikë dhe 26% në drejtimin TIK;
- 63% e maturantëve ushtronin profesionin e tyre (59% në Elektroteknikë dhe 73% në TIK);
- Forma më e zakonshme se si maturantët kishin gjetur punë: nëpërmjet njohjeve familjare (64%) nëpërmjet mësueve/njesisë së zhvillimit (21%) - praktika profesionale (0%);
- 67% e të paragjurmuarve dëshironin të bëheshin pjesë e tregut të punës pas diplomimit (27% të punonin ndërkohë që studionin, 25% të punonin në degën që kishin ndjekur);
- 22% dëshironin të emigronin.

3. Rezultate


Gjetjet kryesore paraqiten më poshtë të organizuara sipas qëllimeve kryesore të sistemit të gjurmimit.

3.1 Statusi i punësimit

Një vit pas diplomimit, cili është statusi i punësimit për të diplomuarit e shkollës?


- Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2021-2022), niveli i të diplomuarve të punësuar një vit pas diplomimit është më i larti në gjashtë vitet e fundit, duke arritur shifrën 67%. Përqindja e të diplomuarve pa punë është 19% dhe 13% e atyre që po ndjekin kualifikime të mëtejshme.
- Një vlerësim krahasues me brezat e tjerë na paraqet një tendencë në rritje të të diplomuarve në marrëdhënie pune (nga 44% tek të diplomuarit në 2017 në 66% tek të diplomuarit në 2022) dhe rrjedhimisht një tendencë në zbritje të papunësisë (nga 33% tek të diplomuarit në 2017 në 19% tek të diplomuarit në 2022).
- Një trend jo të qëndrueshëm rritës e shohim tek numri i të diplomuarve të vetë-punësuar, i cili në 2022 në terma absolut arrin në 11 të vetë-punësuar (9% në terma relativ). Ky numër ka qenë 5 për të diplomuarit në 2017 dhe ka arritur vlerën më të lartë, 17, në 2020.
- Të diplomuarit në 2022 që po ndjekin kualifikime të mëtejshme pas shkollës pa qenë pjesë e tregut të punës janë 17 nga 129 të anketuarit (13%), ndërkohë që 25 të tjerë (19%) po kryejnë studimet dhe janë të punësuar në të njëjtën kohë (rezultat i ngjashëm me 2020).
- Situata e punësimit e disagreguar sipas drejtimit tregon se niveli i të punësuarve në drejtimin Elektroteknikë është më i lartë se ai TIK (71% përkundrejt 61% në TIK). Megjithatë në 2022 krahasuar me një vit më parë kemi një rritje të nivelit të punësimit në TIK me 8 pikë përqindje, ndërkohë që ai në Elektroteknikë është ulur me 3 pikë përqindje.

Figura 4 Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=129.

Figura 5 Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=121, N₂=121, N₃=176, N₄=165, N₅=158, N₆=129.

Figura 6 Punësimi përkundrejt vetë-punësimit



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=121, N₂=121, N₃=176, N₄=165, N₅=158, N₆=129.

Figura 7 Statusi i punësimit Elektroteknikë





Figura 8 Statusi i punësimit TIK



Shënim, figura 7: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=92, N₂=75.

Shënim, figura 8: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=66, N₂=54.

3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit

A lidhet puna aktuale e të diplomuarve me fushën e tyre të arsimit?

- Vetëm 31% e të diplomuarve në 2022 pohojnë se puna që ata bëjnë lidhet me studimet e tyre, duke shënuar vlerën më të ulët ndër breza. Krahasuar me një vit më parë kemi një ndryshim prej 38 pikë përqindje.
- Nëse krahasojmë drejtimet me njëra-tjetrën, shohim se nxënësit e Elektroteknikës kanë arritur të punësohen në 35% të rasteve në një punë që lidhet me fushën e tyre, përkundrejt 24% të TIK. Një trend i ngjashëm vihet re edhe tek brezat e kaluar.
- Në terma absolutë, 21 të diplomuar të (vetë)punësuar në 2017, 21 në 2018, 54 në 2019, 51 në 2020, 61 në 2021 dhe 26 në 2022 punojnë në profesionin e tyre.
- Duke bërë një krahasim të rezultateve me vitet e kaluara, këto mbeten dy arsyt vendimtare të mospërputhjes së punës me fushën e arsimit: pamundësia për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet dhe kushtet/paga e mirë e punës aktuale të të diplomuarit. Në 2022, peshën më të madhe e ka pamundësia për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet me 50% përkundrejt një page më të mirë në punën aktuale e cila shënon 31%.

Figura 9 Lidhja e punës me fushën e arsimit





Figura 10 Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimeve (2020,2021, 2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=53, N₂=59, N₃=96, N₄=102, N₅=103, N₆=85.

Tabela 2 Arsytet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	60%	48%	50%	31%	50%
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	13%	6%	2%	9%	8%
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	0%	18%	2%	17%	4%
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	27%	24%	40%	43%	31%
Tjetër	0%	3%	5%	0%	8%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=30, N₂=33, N₃=42, N₄=35, N₅=52.

3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës Si lidhet puna aktuale e të diplomuarve të punësuar me degën dhe njohuritë e fituara gjatë studimeve?

- Në rezultatet e gjurmimit për të diplomuarit e 2022 përdorimi i njohurive në vendin e punës është vlerësuar me “shumë/jashtëzakonisht shumë” nga 26% e të gjurmuarve. Ky nivel është ulur ndjeshëm krahasuar me një vit më parë (42%). Ndërkohë është rritur niveli i të gjurmuarve të cilët shprehen se njohuritë e tyre janë të përdorura “disi” në punën aktuale të tyre, duke arritur vlerën 35% (16% në 2021).
- Paralelisht, 40% e të diplomuarve në 2022 janë shprehur se njohuritë dhe kompetencat e fituara në shkollë nuk kanë “aspak ose pak” përdorim në punën e tyre, duke mbajtur një nivel konstant në katër vitet e fundit por të përmirësuar krahasuar me të gjurmuarit në 2017 dhe 2018 që shënojnë 62% dhe 58%. Gjithsesi vlen për t’u konsideruar fakti se përqindja e të gjurmuarve që janë përgjigjur “aspak” në 2022 është rritur me 10 pikë përqindje.
- Në lidhjen mes degës së studiuar dhe pozicionit të punës nuk evidentohen ndryshime të rëndësishme krahasuar me një vit më parë. Vihet re një rënie prej 5 pikë përqindje e të gjurmuarve që vlerësojnë me “shumë/jashtëzakonisht shumë” lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera, 39% në 2021 dhe mesatarja ndër vite 32%. Nga ana tjetër, kemi një rritje të lehtë të të gjurmuarve që vlerësojnë me “aspak/pak” lidhjen degë e studiuar-punë (32% në 2021 dhe 39.5% në 2022) ndërkohë që ndër vite kemi një trend zbritës.

Tabela 3 Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2017	55%	7%	12%	10%	16%
Të diplomuar në 2018	44%	14%	20%	10%	12%
Të diplomuar në 2019	22%	18%	29%	14%	16%
Të diplomuar në 2020	17%	24%	28%	16%	16%
Të diplomuar në 2021	17%	25%	16%	21%	20%
Të diplomuar në 2022	27%	13%	34%	11%	15%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=58, N₂=59, N₃=112, N₄=102, N₅=103, N₆=86.

Tabela 4 Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual me studimet

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2017	57%	7%	12%	12%	12%
Të diplomuar në 2018	47%	12%	20%	8%	12%
Të diplomuar në 2019	26%	17%	21%	22%	13%
Të diplomuar në 2020	21%	17%	30%	17%	16%
Të diplomuar në 2021	16%	17%	29%	17%	21%
Të diplomuar në 2022	28%	12%	27%	23%	10%


Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=58, N₂=59, N₃=112, N₄=102, N₅=103, N₆=86.

3.4 Niveli i pagave

Cili është niveli i pagave për të diplomuarit e punësuar një vit pas diplomimit?

- Parë në një këndvështrim krahasues, niveli i pagave të të diplomuarve në 2022 është përmirësuar ndjeshëm pas një gjendjeje konstante në tre vitet e kaluara, gjithsesi të përmirësuar krahasuar nga dy brezat e parë të të gjurmuarve. Ndër të anketuarit në 2022, vetëm 14% kanë një pagë më të ulët se 35.000 LEK (34% në 2021), 64% bëjnë pjesë në fashën 35,001-80,000 LEK (52% në 2021) dhe 22% kanë një page më të lartë se 80,001 LEK (15% në 2021).
- Përqindja e të diplomuarve me pagë më të ulët se 35,000 LEK ka rënë ndër vite, duke shkuar nga 79% në 2017 në 14% në 2021. Kjo është reflektuar në një rritje të numrit të të diplomuarve që përfshihen në nivelin e pagave 35,001-50,000 LEK dhe më shumë se 80,001 LEK.
- Duke i parë në një nivel krahasues sipas drejtimeve, në 2022 të diplomuarit në Elektroteknikë janë më mirë të paguar se ato në TIK, një trend që vihet re edhe tek të diplomuarit e brezave të shkuar. Në 2022, vetëm 10% në Elektroteknikë kanë pagën më të ulët se 35.000 LEK në krahasim me 21% në TIK dhe 31% vitit e kaluar. 60% në Elektroteknikë kishin një shpërblim financiar më të lartë se 50,000 LEK përkundrejt 42% në TIK dhe 32% vitin e kaluar.

Figura 11 Niveli i pagave një vit pas diplomimit (neto)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=53, N₂=59, N₃=96, N₄=102, N₅=103, N₆=86.

Figura 13 Niveli i pagave Elektroteknikë





Figura 12 Niveli i pagave TIK



Shënim, figura 12: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=35, N₂=33.


Shënim, figura 13: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=68, N₂=52.

3.5 Kushtet e punës

Cilat janë karakteristikat kryesore dhe kushtet e punës për grupin e diplomuarve të punësuar?


- Ndër vite, 9 nga 10 të diplomuar të cilët janë në marrëdhënie pune e kryejnë këtë të fundit me kohë të plotë. Nëse vlerësojmë të dhënat e të diplomuarve të vitit të fundit, 2022, përqindja e të diplomuarve që punojnë me kohë të plotë ka shkuar në nivelin 82%, ndërkohë që puna me kohë të plotë sezonale është 14% dhe ajo me kohë të pjesshme mbetet në nivele minimale 4%.
- Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë tek të gjurmuarit e këtij viti shohim një ulje prej 7 pikë përqindje të atyre që punojnë në biznese të vogla me 1-4 punonjës (nga 26% në 2021 në 19% në 2022). Ndërkohë 31% e të diplomuarve janë të punësuar në biznese me 5-9 punonjës dhe 27% në ndërmarrje me 10-49 punonjës, duke shënuar një rritje nga një vit më parë. 24% e të gjurmuarve janë të punësuar në biznese të mëdha me mbi 50 punonjës.
- Duke bërë një krahasim me vitin e kaluar, vlen për t'u shënuar se ka patur një rritje të nivelit të të diplomuarve të cilët punojnë pa nënshkruar një kontratë, nga 26% në 2021 në 34% në 2022- ndër vite shohim një luhajtje të këtij niveli ku vlera më e lartë është arritur në 2017 me 505 dhe më e ulëta në 2019 me 20%. Vlera e të diplomuarve që kanë nënshkruar një kontratë ma afat të pacaktuar në 2022 shënon 49%, ndërsa 18% shënon ajo me afat të caktuar.
- Për sa i përket ndërgjegjësimit të të gjurmuarve rreth pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, vitin e fundit shënon 80% (82% mesatarja ndër vite). 10% deklarojnë që nuk kanë dijani në lidhje me këtë gjë.

Figura 14 Punësimi me kohë të plotë përkundrejtë me kohë të pjesshme




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=48, N₂=45, N₃=81, N₄=85, N₅=89, N₆=74.

Figura 15 Madhësia e kompanisë




Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=48, N₂=45, N₃=81, N₄=85, N₅=89, N₆=74.

Figura 16 Lloji i kontratës



Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=48, N₂=45, N₃=81, N₄=85, N₅=89, N₆=74.

Figura 17 Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi



Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=48, N₂=45, N₃=81, N₄=85, N₅=89, N₆=74.

3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës

Sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjehen të diplomuarit në vendin e tyre të punës?

- Të diplomuarit përgjithësisht ndihen (shumë) të sigurt me punën e tyre - nëse bëhet një vlerësim mesatar midis gjashtë brezave 65% e kanë pohuar një gjë të tillë. Nga ana tjetër, 24% e tyre kanë perceptime neutrale rreth kësaj çështjeje dhe vetëm 12% ndihen (shumë) të pasigurt. Rezultate shumë të ngjashme shohim edhe tek të diplomuarit në 2022.
- Duke bërë një krahasim të rezultateve ndërmjet sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës mund të themi se ekziston një lidhje e ndërsjellë mes tyre; me rritjen e sigurisë rritet edhe

kënaqësia në punë. Në 2022 70% e të diplomuarve ndihen (shumë) të kënaqur, 18% janë neutral dhe vetëm 14% janë shprehur (shumë) të pakënaqur.

Tabela 5 Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale

	Të diplomuar 2017	Të diplomuar 2018	Të diplomuar 2019	Të diplomuar 2020	Të diplomuar 2021	Të diplomuar 2022
Shumë i/e pasigurt	2%	9%	4%	4%	9%	7%
I/e pasigurt	19%	2%	5%	7%	4%	4%
Neutral	13%	38%	27%	25%	20%	20%
I/e sigurt	40%	36%	42%	38%	44%	36%
Shumë i/e sigurt	27%	16%	22%	27%	22%	32%
Shumë i/e pakënaqur	4%	11%	2%	5%	3%	7%
I/e pakënaqur	8%	7%	2%	6%	4%	7%
Neutral	25%	29%	26%	15%	17%	18%
I/e kënaqur	35%	33%	47%	54%	54%	42%
Shumë i/e kënaqur	27%	20%	22%	20%	21%	27%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=48, N₂=45, N₃=81, N₄=85, N₅=89, N₆=74.

3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Sa duhet të presin mesatarisht të diplomuarit derisa të fillojnë punën e tyre të parë?


- Rezultatet e të anketuarve në 2022 shënojnë vlerat më të larta ndër vite për sa i përket periudhës kohore që iu nevojitet të diplomuarve për gjetur punën e tyre të parë; 64% janë punësuar para diplomimit, 17% një muaj pas diplomimit, 7% 1-3 muaj pas diplomimit, 2% 3-6 muaj pas diplomimit dhe 10% 6 muaj deri në 1 vit pas diplomimit.
- Nëse bëhet një vlerësim mesatar midis gjashtë brezave, 54% e të diplomuarve arrijnë të punësohen para se të përfundojnë shkollën. Vlera më e ulët është ajo e të diplomuarve në 2019, ku vetëm 38% e rasteve ishin në marrëdhënie pune para se të diplomoheshin.
- Mesatarisht 8 në 10 të diplomuar (79%) kanë filluar punën e tyre të parë maksimumi 3 muaj pas diplomimit, duke lënë një përqindje shumë të vogël të atyre që gjejnë punë 3-12 muaj pas diplomimit.

Tabela 6 Periudha kohore në kërkim të një pune

	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Para diplomimit	55%	61%	38%	55%	58%	64%
1 muaj pas diplomimit	11%	14%	18%	16%	14%	17%
1 - 3 muaj pas diplomimit	4%	11%	8%	16%	10%	7%
3 - 6 muaj pas diplomimit	17%	5%	20%	6%	6%	2%
6 - 9 muaj pas diplomimit	8%	5%	8%	2%	4%	7%
9 - 12 muaj pas diplomimit	6%	4%	8%		4%	3%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=53, N₂=56, N₃=97, N₄=93, N₅=103, N₆=83.

Figura 18 Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2021)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=83.

3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Si e gjejnë të diplomuarit punën e tyre të parë?

- Lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre janë forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit kanë gjetur punë për herë të parë me një mesatare prej 69% në të gjashtë brezat.
- Në 2022 mbetet i ulët niveli i të diplomuarve të cilët arrijnë të punësohen në sajë të praktikës profesionale në biznes (4%).
- Megjithatë shohim një rritje me 6 pikë përqind të të diplomuarve që kanë parë si mundësi kërkimin e një vendi pune nëpërmjet njoftimeve në faqe interneti e media sociale, duke arritur vlerën 23% (niveli më i lartë ndër vite).

Si i ndihmon shkolla gjatë periudhës së tranzicionit drejt tregut të punës?

- Dy janë format më të përmendura nga të diplomuarit në 2022 në lidhje me mbështetjen nga shkolla gjatë periudhës së tranzicionit: instruksionet mbi mënyrën si kërkohet dhe aplikohet në një vend pune (34%) dhe orientimi për mundësitë e ndryshme të punësimit (31%).
- Edhe pse shohim një trend zbritës nga brezi në brez, të gjurmuarit vazhdojnë të shprehen se shkolla nuk i ka ndihmuar gjatë periudhës së tranzicionit – në vlera absolute 44 nga 58 të gjurmuar në 2017 (76%), 36 nga 59 në 2018 (61%), 40 nga 112 në 2019 (36%), 27 nga 102 në 2020 (26%), 36 nga 103 në 2021 (35%) dhe 31 nga 86 në 2022 (36%).

Tabela 7 Mënyrat e gjetjes së punës së parë

	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	19%	4%	12%	13%	17%	23%
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	70%	75%	70%	71%	62%	65%
Nga praktika profesionale në biznes	6%	0%	0%	5%	4%	4%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	4%	16%	8%	5%	10%	7%
Nga mësuesi	0%	2%	3%	2%	4%	0%
Nga Zyra e Punësimit	2%	0%	1%	0%	1%	0%
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë	0%	0%	3%	0%	0%	1%
Tjetër	0%	4%	2%	3%	2%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=48, N₂=45, N₃=81, N₄=85, N₅=89, N₆=74.

Tabela 8 Ndhimja e shkollës në gjetjen e punës së parë

	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	12%	10%	34%	27%	28%	34%
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	14%	19%	30%	35%	31%	31%
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	10%	8%	13%	15%	13%	15%
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	76%	61%	36%	26%	35%	36%
Tjetër	0%	3%	2%	8%	4%	4%


Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=58, N₂=59, N₃=112, N₄=102, N₅=103, N₆=83.

3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Çfarë kualifikimi të mëtejshëm po ndjekin të diplomuarit?


- 32% e të gjurmuarve në 2022 ndjekin kualifikime të mëtejshme një vit pas diplomimit ku 19% prej të cilëve janë edhe në marrëdhënie pune ndërkohë që kryejnë studimet.
- Ndër vite, në shkollën Gjergj Canco është rritur numri i të diplomuarve të cilët ndjekin studime të mëtejshme dhe paralelisht numri i të diplomuarve që studiojnë dhe punojnë në të njëjtën kohë (0% në 2017, 19% në 2022).
- Si në vitet paraardhëse, në 2022 pjesa më e madhe e të diplomuarve që ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë zgjedhur universitetin (93% ose 39 nga 42 që vazhdojnë studime). Prej tyre, 16 (38%) studiojnë në institucione publike dhe 26 (62%) në institucione private. Në 28 raste (67%) fusha e studimeve që po ndjekin tani lidhet me shkollën që kanë bërë - një nivel i ulët krahasuar me vitet e kaluara (75% në 2020 dhe 83% në 2021).
- Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme, kryesisht këto mbeten arsyet themelore: për të arritur një kualifikim më të lartë (5% në 2022) dhe për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë (21% në 2022). Në 2022 vihet re një rritje e numrit të të gjurmuarve që janë përgjigjur se kanë vazhduar studime të mëtejshme për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale (19%).

Figura 19 Llojet e kualifikimeve të mëtejshme



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=121, N₂=121, N₃=176, N₄=165, N₅=158, N₆=129.

Figura 20 Llojet e kualifikimeve të mëtejshme



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=28, N₂=25, N₃=46, N₄=44, N₅=53, N₅=42.

Figura 21 Lloji i universitetit





Figura 22 Lidhja e fushës së studimeve/trajnimeve me profesionin



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=44, N₂=53, N₅=42.

Tabela 9 Arsytet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme

	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Për të fituar një kualifikim më të lartë	50%	40%	48%	50%	60%	55%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	43%	40%	38%	32%	25%	21%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	4%	16%	7%	18%	11%	19%
Nuk po gjeja dot punë	0%	0%	7%	0%	0%	0%
Tjetër	4%	4%	0%	0%	4%	5%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=28, N₂=25, N₃=29, N₄=44, N₂=53, N₅=42.

3.10 Të diplomuarit pa punë

Çfarë vështirësish hasin të diplomuarit që gjenden pa punë një vit pas diplomimit?


- Viti 2022 shënon një nivelin të ulët të papunësisë me 19% (24 nga 129), ku 63% (15 nga 24) e të gjurmuarve pa punë po kërkon në mënyrë aktive të integrohet në tregun e punës.

- Arsyet që mendohet se sjellin pamundësinë për të gjetur një punë tek të diplomuarit në 2022 janë: mungesa e eksperiencës së punës (6 nga 15), mungesa e kontakteve të duhura për të gjetur një punë (4 nga 15), mungesa e ofertës për punë në drejtimin e ndjekur nga i diplomuari (2 nga 15) dhe tjetër (2 nga 15).
- Të pyetur rreth formave që përdorin për të kërkuar një vend punë në 2022, nga një total prej 15 të gjurmuarve që po kërkojnë për punë 11 prej tyre (73%) kanë përzgjedhur 'nëpërmejt njohjeve ose lidhjeve familjare', 7 (47%) kanë përzgjedhur 'nëpërmjet njoftimeve për punë në faqe internet, media sociale, gazatë, etj', dhe në 4 raste (27%) 'duke kontaktuar drejtpërdrejtë me bizneset'.
- 8 nga 24 e të diplomuarve të papunë (33%) janë përgjigjur se kanë qenë në marrëdhënie pune më parë.

Tabela 10 Papunësia ndër vite

Të diplomuar në 2017	33%
Të diplomuar në 2018	28%
Të diplomuar në 2019	28%
Të diplomuar në 2020	25%
Të diplomuar në 2021	18%
Të diplomuar në 2022	19%

Figura 23 Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë



Shënim, tabela 10: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=121, N₂=121, N₃=176, N₄=165, N₅=158, N₆=129.


Shënim, figura 23: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=41, N₂=29, N₃=24.

Tabela 11 Arsyeja kryesore pas papunësisë

	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Më mungon eksperiencia e punës	13%	12%	18%	24%	38%	40%
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	8%	15%	6%	0%	4%	0%
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	8%	9%	10%	9%	13%	13%
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	10%	24%	16%	36%	13%	27%
Nuk ka punë në qarkun tim	13%	26%	18%	15%	13%	7%
Jam i/e angazhuar në punë familjare	23%	6%	0%	6%	0%	0%
Nuk kam burime të mjaftueshme për t'u vetë-punësuar	0%	9%	0%	0%	0%	0%
Nga situata e krijuar nga pandemia e COVID-	0%	0%	18%	0%	0%	0%
Nuk di si të kërkoj për punë	0%	0%	0%	0%	4%	0%
Tjetër	28%	0%	14%	9%	17%	13%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=40, N₂=34, N₃=50, N₄=33, N₅=24, N₆=15.

Figura 24 Metoda e kërkimit për punë (të diplomuar në 2020, 2021)




Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. Baza: N=33, N₂=24, N₃=15.

Tabela 12 Arsyt kryesore e mos kërkimit për punë

	Të diplomuar 2020	Të diplomuar 2021	Të diplomuar 2022
Po pres të filloj punë së shpejti	2	2	2
Nuk kam besim se do gjej një punë	1	0	0
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	1	1	6
Kam në plan të largohem nga vendi	4	2	1

Figura 25 Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune



Shënim, tabela 12: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N₁=8, N₂=5, N₃=9,

Shënim, figura 25: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N₁=40, N₂=34, N₃=49, N₄=41, N₅=29, N₆=15.

3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë

Për t'i përgatitur më mirë nxënësit për tregun e punës, në çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla?

- Në një vlerësim retrospektiv të gjurmuarit në 2022 mendojnë se aspektet që lidhen me praktikatat në biznes janë ato që kanë më shumë nevojë për përmirësim nga shkolla. Gjithsesi nevoja për 'shumë ose jashtëzakonisht shumë' përmirësim në këto aspekte është më e ulët se vitet e kaluara.
- Të diplomuarit kanë vlerësuar me 'shumë ose jashtëzakonisht shumë' këto aspekte: praktika në biznes (61%), bashkëpunimi me bizneset (61%), dhe bashkëpunimi me zyrat e punës (57%).
- Nga ana tjetër, infrastruktura (43%), aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve (46%) dhe tekstet dhe materialet mësimore (47%) janë aspektet që nxënësit i shohin si më të konsoliduara dhe nuk ka nevojë për shumë përmirësim.
- Në 2022 shohim një ulje të nivelit të të diplomuarve të cilët do të zgjidhnin të njëjtën degë/shkollë (67% dhe 65%). Kur i studiojmë të dhënat të disagreguara sipas drejtimit vëmë


re se tek të diplomuarit në Elektroteknikë është më i theksuar fakti që nuk do të zgjidhinin të njëjtën shkollë, ndërkohë që në zgjedhjen e së njëjtës degë përqindjet janë të njëjta.

Tabela 13 Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë “shumë/jashtëzakonisht shumë”

	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Infrastruktura	64%	68%	40%	33%	46%	43%
Kurrikula		32%	36%	37%	53%	50%
Tekstet dhe materialet	55%	29%	47%	39%	57%	47%
Metodat e mësimdhënies	38%	29%	44%	42%	56%	48%
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve		41%	43%	35%	54%	46%
Praktika në shkollë	81%	66%	63%	52%	67%	54%
Praktika në biznes	83%	73%	60%	58%	72%	61%
Këshillimi i karrierës	69%	46%	50%	47%	61%	55%
Bashkëpunimi me bizneset		61%	63%	55%	67%	61%
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	76%	56%	62%	54%	69%	57%

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=58, N₂=59, N₃=112, N₄=165, N₅=143, N₆=129.

Figura 26 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë



Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁=121, N₂=176, N₃=165, N₄=158, N₅=129.

Tabela 14 Përzgjedhja e së njëjtës degë/shkollë sipas drejtimit

		Elektronikë	Elektroteknikë	TIK
Të diplomuar në 2018	Degë	55%	70%	91%
	Shkollë	48%	64%	69%
Të diplomuar në 2019	Degë	70%	80%	81%
	Shkollë	68%	77%	71%
Të diplomuar në 2020	Degë		80%	77%
	Shkollë		74%	84%
Të diplomuar në 2021	Degë		77%	68%
	Shkollë		75%	85%
Të diplomuar në 2022	Degë		68%	67%
	Shkollë		63%	69%

Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N₁: EL=33, ELT=53, TIK=35; N₂: EL=47, ELT=87, TIK=42; N₃: ELT=122, TIK=43; N₄: ELT=92, TIK=66; N₅: ELT=75, TIK=54.

3.12 Planet për të ardhmen

Çfarë planesh kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtejshëm?

- Aspiratat për sipërmarrje janë një trend në rritje tek të diplomuarit në shkollën Gjergj Canco, ku në 2022 shënon nivelin më të lartë ndër vite me 53% (13% në 2017).
- Si në vitet pararendëse, në planet e tyre për të ardhmen pjesa më e madhe e të diplomuarve shprehen se dëshirojnë: të kenë filluar biznesin e tyre (53%), të gjejnë një punë të lidhur ngushtë me fushën e studimeve (28%), të emigrojnë jashtë vendit (19%) dhe të ndjekin studime të mëtejshme (19%).

Tabela 15 Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme

	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Të jem punësuar	10%	13%	23%	15%	15%	13%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	45%	36%	42%	41%	36%	28%
Të kem filluar biznesin tim	13%	21%	34%	33%	44%	53%
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	33%	24%	20%	19%	24%	19%
Të kem emigruar jashtë vendit	21%	31%	26%	27%	25%	19%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	1%	1%	1%	1%	1%	2%
Tjetër	4%	6%	4%	2%	1%	4%

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. Baza: N₁=121, N₂=121, N₃=176, N₄=165, N₅=158, N₆=129.

4. Përfundime

Në këtë raport paraqiten rezultatet kryesore nga gjurmimi i të diplomuarve të shkollës 'Gjergji Canco' duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në 2017.

Disa nga gjetjet kryesore të gjurmimit **për të diplomuarit e 2022** janë përmbledhur më poshtë:

- 89% e të diplomuarve të 2022 u gjurmuan një vit pas diplomimit – përqindja më e lartë e të gjurmuarve ndër vite.
- Niveli i të diplomuarve të punësuar një vit pas diplomimit është më i larti në pesë vitet e fundit duke arritur nivelin 67%. Përqindja e të diplomuarve pa punë është 19% dhe 13% e atyre që po ndjekin kualifikime të mëtejshme.
- Situata e punësimit e disagreguar sipas drejtimit tregon se niveli i të punësuarve në drejtimin Elektroteknikë është më i lartë se ai TIK (71% përkundrejt 61% në TIK). Megjithatë në 2022 krahasuar me një vit më parë kemi një rritje të nivelit të punësimit në TIK me 8 pikë përqindje, ndërkohë që ai në Elektroteknikë është ulur me 3 pikë përqindje.
- Vetëm 31% e të diplomuarve në 2022 pohojnë se puna që ata bëjnë lidhet me studimet e tyre, duke shënuar vlerën më të ulët ndër breza. Krahasuar me një vit më parë kemi një ndryshim prej 38 pikë përqindje; nxënësit e Elektroteknikës kanë arritur të punësohen në 35% të rasteve në një punë që lidhet me fushën e tyre, përkundrejt 24% të TIK.
- Parë në një këndvështrim krahasues, niveli i pagave të të diplomuarve në 2022 është përmirësuar ndjeshëm pas një gjendjeje konstante në tre vitet e kaluara, gjithsesi të përmirësuar krahasuar nga dy brezat e parë të të gjurmuarve. Ndër të anketuarit në 2022, vetëm 14% kanë një pagë më të ulët se 35.000 LEK (34% në 2021), 64% bëjnë pjesë në fashën 35,001-80,000 LEK (52% në 2021) dhe 22% kanë një pagë më të lartë se 80,001 LEK (15% në 2021).
- Rezultatet e të anketuarve në 2022 shënojnë vlerat më të larta ndër vite për sa i përket periudhës kohore që iu nevojitet të diplomuarve për gjetur punën e tyre të parë; 64% janë punësuar para diplomimit, 17% një muaj pas diplomimit, 7% 1-3 muaj pas diplomimit, 2% 3-6 muaj pas diplomimit dhe 10% 6 muaj deri në 1 vit pas diplomimit.
- Lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre janë forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit kanë gjetur punë për herë të parë me një mesatare prej 69% në të gjashtë brezat. Në 2022 mbetet i ulët niveli i të diplomuarve të cilët arrijnë të punësohen në sajë të praktikës profesionale në biznes (4%).
- Ndër vite, në shkollën Gjergji Canco është rritur numri i të diplomuarve të cilët ndjekin studime të mëtejshme dhe paralelisht numri i të diplomuarve që studiojnë dhe punojnë në të njëjtën kohë (0% në 2017, 19% në 2022).
- Viti 2022 shënon një nivelin të ulët të papunësisë me 19% (24 nga 129), ku 63% (15 nga 24) e të gjurmuarve pa punë po kërkon në mënyrë aktive të integrohet në tregun e punës.
- Në një vlerësim retrospektiv të gjurmuarit në 2022 mendojnë se aspektet që lidhen me praktikën në biznes janë ato që kanë më shumë nevojë për përmirësim nga shkolla. Gjithsesi nevoja për 'shumë ose jashtëzakonisht shumë' përmirësim në këto aspekte është më e ulët se vitet e kaluara. Të diplomuarit kanë vlerësuar me 'shumë ose jashtëzakonisht shumë' këto aspekte: praktika në biznes (61%), bashkëpunimi me bizneset (61%) dhe bashkëpunimi me zyrat e punës (57%), ndërkohë më pak nevojë për përmirësim kanë infrastruktura (43%), aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve (46%) dhe tekstet dhe materialet mësimore (47%).
- Në 2022 shohim një ulje të nivelit të të diplomuarve të cilët do të zgjidhnin të njëjtën degë/shkollë (67% dhe 65%). Kur i studiojmë të dhënat të disagreguara sipas drejtimit vëmë re se tek të diplomuarit në Elektroteknikë është më i theksuar fakti që nuk do të zgjidhnin të njëjtën shkollë, ndërkohë që në zgjedhjen e së njëjtës degë përqindjet janë të njëjta.
- Aspiratat për sipërmarrje janë një trend në rritje tek të diplomuarit në shkollën Gjergji Canco, ku në 2022 shënon nivelin më të lartë ndër vite me 53% (13% në 2017).